AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS
FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E JASHTME TË PËRGJITHSHME
MINISTRIA E SHTETIT PËR DIASPORËN

NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#48

Miratohet urdhri për emërimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të QSPA-së

Miratohet Urdhri Nr. 5, datë 26.2.2020, i Ministrit të Shtetit për Diasporën për "Miratimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët". Në përbërje të këtij Këshilli janë nëntë persona përfaqësues nga Akademia e Shkencave; Akademia e Studimeve Albanologjike; ministria përgjegjëse për politikën e jashtme; ministria përgjegjëse për kulturën, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës; Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe tre përfaqësues nga komuniteti Arbëresh, njëri prej të cilëve është nga komuna e Zarës, në Kroaci.Këshilli Koordinues pranë QSPA-së do të funksionojë si organ këshillimor, për projektet e studimeve e publikimeve të QSPA-së, në përputhje me dokumentet strategjike për marrëdhëniet me Diasporën, me programet kërkimore-shkencore si dhe për përcaktimin e planit të aktiviteteve dhe çdo loj organizimi tjetër, në zbatim të fushës së përgjegjësisë të QSPA-së.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store këtu: Play store këtu:

"Letra nga Diaspora", takimi i parë i shkrimtarëve shqiptarë në botë

Autorë, përkthyes, studiues dhe emra të njohur të letrave shqipe, brenda dhe jashtë vendit, janë bashkuar në eventin kulturor Takimi i Shkrimtarëve të Diasporës "Letra nga Diaspora".Në këtë takim të veçantë, organizuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, po diskutohet për letërsinë, gjuhën dhe vlerat atdhetare. Në përshëndetjen e tij ministri Majko, duke vlerësuar kontributin e autorëve të njohur të letërsisë shqipe, të cilët largësia nga atdheu i nxiti të pasuronin letërsinë, artin dhe identitetin kombëtar, theksoi se letërsia e diasporës i ka fillesat te Rilindja Kombëtare, nga Frashëllinjtë në Turqi, te De Rada në Itali."Është koha të flitet për letërsinë kombëtare shqiptare. Ju jeni ambasadorët e kulturës dhe të penës shqiptare. Ky nuk është emërim administrativ dhe as kompliment. Ai ka peshën e fjalës dhe të heshtjes", u shpreh ministri Majko.Më tej, ai shtoi se mbi njëqind shkrimtarë shqiptarë aktivë në gjithë botën po krijojnë e kontribuojnë për letërsinë tonë kombëtare, ndërkohë në komunitetet e shumta shqiptare, si shoqata "Lidhja e Shkrimtarëve dhe Krijuesve në Gjermani e Austri", po bëhen promotorë të rëndësishëm të përhapjes së letërsisë shqiptare. Ministrja e Kulturës, znj. Elva Margariti, në fjalën e saj vlerësoi kontributin e të gjithë personalitetève shqiptarë në fushën e kulturës, të cilët në kohët më të errëta që ka kaluar Shqipëria kanë kontribuar në mbijetesën e saj dhe kanë shërbyer si ambasadorët më të mirë të vendit. Takimi, i organizuar në panele të ndryshme tematike e lexime autoriale, synon të ndihmojë në njohjen, promovimin dhe nxitjen e komunikimit të shkrimtarëve të Diasporës me lexuesit dhe botuesit shqiptarë si dhe prezantimin e letërsisë së migracionit, e cila luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe promovimin e albanologjisë në botë.

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme

App store këtu: Play store këtu:

Takimi i Juristëve në Diasporë

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe Ministrinë e Drejtësisë, në 4 prill 2020 do të organizojnë në Tiranë, Takimin e Juristëve në Diasporë. Takimi synon të bëjë bashkë profesionistë të Diasporës në fushën e drejtësisë, avokatë dhe juristë që punojnë jashtë vendit, me qëllim krijimin e një platforme për të shkëmbyer përvojat e praktikat më të mira për përballimin e sfidave aktuale në sistemin e drejtësisë. Për të marrë pjesë në këtë takim ose për informacione të mëtejshme, ju lutemi na kontaktoni në adresën: info@akd.gov.al

Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti

Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin "e-Albania".

Takim dypalësh me Atasheun e Arsimit të ambasadës turke në Qendrën e Botimeve për Diasporën

Drejtoresha e QBD - së, znj. Mimoza Hysa zhvilloi një takim me z. Atakan Doğan, Atasheun e Arsimit të Ambasadës së Republikës së Turqisë në Shqipëri për bashkëpunim në realizimin e projektit të platformës dygjuhëshe.Z. Doğan informoi se mësimi i gjuhës shqipe në Turqi është pjesë e programit shkollor si gjuhë fakultative dhe ndiqet prej rreth 50 mijë nxënësish. Ministria e Arsimit ka hartuar dhe shpërndarë për nxënësit e gjuhës shqipe tekste shkollore në tri nivele të hartuara nga Universiteti i Trakisë atje.Një nga pikat kryesore të takimit ishte mbështetja e Fjalorit Shqip-Turqisht për nxënësit e gjuhës shqipe në Turqi. Pala turke mori përsipër botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e 50 mijë kopjeve të fjalorit të përgatitur nga Qendra e Botimeve për Diasporën, kopje të cilat do të jenë gati për vitin shkollor 2020-2021.

"Corriere della Sera" në Takimin e Shkrimtarëve të Diasporës"

Një nga synimet e organizimit të Takimi të Shkrimtarëve të Diasporës ishte dhe promovimi i letërsisë shqipe jashtë vendit. Aty gazetarja e "Corriere della sera" Jessica Chia prezantoi projektin më të ri të faqes "Letture" të një prej gazetave më të mëdha në Ballkan dhe Europë, përmes së cilës synohet promovimi i autorëve të Ballkanit në Europë.Në shkrimin e saj "Shqipëria vë në qendër të vëmendjes rolin krijues të Diasporës" ajo bën një prezantim të takimit dhe të autorëve pjesëmarrës.

KKD / Anila Hyka Smorgrav takim me studentët shqiptarë në Paris

Nënkryetarja e Këshillit Koordinues të Diasporës Anila Hyka Smorgrav zhvilloi një takim me rrjetin e studentëve shqiptarë në Paris.Përmes një shkrimi në profilin e saj në rrjetin social "Facebook", ajo njoftoi për pjesëmarrjen në këtë takim qëllim i të cilit ishte shkëmbimi i ideve të reja dhe bashkëpunimi për realizimin e aktiviteteve e forcimin e lidhjeve me komunitetin shqiptar në Francë."Mes studentëve ndjehesh gjithnjë e re. Kënaqësi të isha e ftuar në takimin e radhës me rrjetin e studentëve të zonës së Parisit, të shkëmbenim mendime përvojat tona si dhe ndarje idesh të reja për bashkëpunim. Përmes Associacion Albania, studentët dhe të rinjtë do të gjejnë jo vetëm mbështetjen për aktivitete të ndryshme të studentëve por Albania është angazhuar të përkrahë dhe ju krijojë mundësi çdo projekti që do ti shërbejë forcimit të lidhjes mes studentëve në komunitetin shqiptar, ndihmës për tu integruar me mirë, si dhe që promovon përpjekjet e tyre për të kontribuar në vendin amë", ka shkruar Smorgrav.

KKD / Brikena Muharremi nominohet për çmimin "Women in Law 2020"

Avokatja shqiptare në Mbretërinë e Bashkuar, Brikena Muharremi, anëtare e Këshillit Koordinues të Diasporës, është nominuar për çmimin "Women in Law 2020", një çmim i Odës së Avokatëve të Anglisë për gratë e suksesshme në fushën e drejtësisë.Përmes një deklarate në profilin e saj në "Facebook" ajo ka njoftuar lidhur me nominim e saj në mesin e avokate të tjera të suksesshme në Angli"Është nder dhe privilegj që jam nominuar për çmimin Women in Law 2020 (Gratë në Drejtësi) dhe që jam në mesin e të nominuarave tjera, avokate të suksesshme në Angli. Çmimi përkrahet nga Oda e Avokatëve të Anglisë dhe u jipet grave të cilat frymëzojnë të tjerët me të arritur at e tyre në fusha të ndryshme të drejtësisë. Çmimet do të ndahen më 2 qershor në Londër.", – ka shkruar ajo.

KKD / Gazmend Kapllani në konferencën "Holokausti" në Jugosllavi dhe Ballkan

Gazmend Kapllani, anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës ishte pjesë e panelit dedikuar Shqipërisë në konferencën "Holocaust in Yugoslavia and the Balkans". (Holokausti në Jugosllavi dhe Ballkan).Kapllani, përmes një postimi në profilin e tij në "Facebook", ka njatë një fragment nga fjalimi i tij me titull "Paradoksi i Mëresisë". Nder të tjera, ai ka shkruar: "I lumtur që ndava panelin me studiuesit e jashtëzakonshëm Tanya Domi dhe Laura Cohen, Astrit Bido, drejtorin e Arkivit të Shtetit Shqiptar që trajtoi dokumente të mallë autentike për shpëtimin e hebrenjve e europianë në Shqipëri dhe Tauta Skenderi që për herë të parë solli para një audience të gjerë historitë e shpëtimit të hebrenjve e europianë nga popullata dhe autoritetet lokale shqiptare e kosovare.Veçanërisht falënderues që shkrimtari i madh Aleksander Hemon ishte në radhën e parë duke na nderuar me praninë e tij. Falënderime të veçanta për Zërin e Amerikës që regjistruan të gjitha ndërhyrjet e kolegëve dhe mqve tanë nga Sarajeva, Kroacia, Serbia etj".Konferenca "Holocaust in Yugoslavia and the Balkans" (Holokausti në Jugosllavi dhe Ballkan) është organizuar nga Instituti Harriman në Universitetin e Columbias në New York, SHBA.